

VENDIM
Nr. 57, datë 1.10.2025

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN E
PJESËMARRJES INFLUENCUESE (TË TËRTHORTË) NË KAPITALIN
AKSIONAR TË “BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE” SHA**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të shkronjës “gj”, të pikës 1, të nenit 24 dhe nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (të tërthortë) në masën 23.68% të shoqërisë “MOSCOPOLE II” L.L.C, SHBA, në kapitalin aksioner të “Bankës Amerikane të Investimeve” sh.a.

2. Ngarkohet Banka Amerikane e Investimeve të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përfundimin e transaksionit të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko